

AKT THEMELIMI

I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“Varan Transport” shpk

Në Tiranë, sot më datë 24.01.2022 Z.Fatih Küçük, atësia Ömer , i datëlindjes 23.10.1977 lindur në Stamboll dhe banues në Rruga Hasrama, Ambientet e Shoqerise Cagatay Logistics Albania Shpk , Fshati Mucaj ,Vore, Tirane, shtetas turk, madhor, me zotësi juridike për të vepruar, e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit të mbajtur prej tij me nr. U25160154 dhe numër Personal 30200470624, Z.Mustafa Emin Ceyhan, atësia Mehmet , i datëlindjes 18.04.2002 lindur në Baçilar dhe banues në Merkez mahallesi 674. Sokak no: 52 d:20 baçilar/Stamboll,Turqi shtetas turk , madhor, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit të mbajtur prej tij me nr U20875241 dhe numër Personal 43057425730 dhe Z.Muhammed Ceyhan, atësia Mehmet , i datëlindjes 05.09.2000 lindur në Baçilar dhe banues në Merkez mahallesi 674. Sokak no: 52 d:20 baçilar/Stamboll,Turqi shtetas turk, madhor, me zotësi juridike për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit të mbajtur prej tij me nr U20875241 dhe numër Personal 43057425730 , te cilet në cilësinë e “ortakut themelues”, me vullnet të lirë e të plotë,hartojne këtë akt themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “Varan Transport” shpk mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” të ndryshuar, në ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1

Emërtimi

Shoqëria emërohet “Varan Transport” shpk ajo është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (e cila këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “Varan Transport” shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar

pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gjëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë kryesore në Tiranë, në adresën: **Apartamenti nr.7, Godina 5 , Shkalla 1 , Kati 2, Kashar, Tiranë** Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale brenda edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitet në këto fusha:

-Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash per vete dhe per trete.Import-eksport, tregtim te artikujve te ndryshem me shumice dhe pakice. import-eksport te mallrave industriale dhe ushqimore, frutaperime, hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike, lendeve te paperpunuara, te bimeve medicinale, kimikate te ndryshme, materiale elektrike, elektronike, pajisje elektroshëpiake, makinadhe pjese kembimi per makina, per automjete dhe sherbimi eriparimi i tyre, pika servisi, lavazh, punirne druri e duraluminji, prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit. Shoqeria mund te kryeje veprimitari te tjera te lidhura opo ne funksion te objektit te mesiperme.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 400 000 lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga "ortaket" e shoqërisë, Z.Fatih Küçük i cila eshte zotëruesh i 1(nje) kuote me vlerë 1 200 000 lekë qe perfaqeson 50% te kapitalit themeltar te shoqerise, Z.Mustafa Emin Ceyhan i cili eshte zotëruesh i 1(nje) kuote me vlerë 600 000 lekë qe perfaqeson 25% te kapitalit themeltar te shoqerise dhe Z. Z.Muhammed Ceyhan i cili eshte zotëruesh i 1(nje) kuote me vlerë 600 000 lekë qe perfaqeson 25% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organ Vendimmarrës

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Ortaku i Vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetëm, vendos për çështje si:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimeve
- e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b. shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c. investime;
- d. vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administratori i shoqërisë **Z.Fatih Küçük**, atësia **Ömer**, i datëlindjes **23.10.1977**, lindur në Stamboll dhe banues në **Ruga Hasrama, Ambientet e Shoqerise Cagatay Logistics Albania Shpk**, Fshati Mucaj ,Vore, Tirane, shtetas turk, madhor, me zotësi juridike për të vepruar, e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit të mbajtur prej tij me nr. U25160154 dhe numër Personal 30200470624,

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;
- b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesë këto dokumente përparrë ortakut të vetëm për miratim;
- e. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g. raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur sipas Administratori përfshihet një marrëdhënie financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet e shtetit Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoritetet doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga Ortaku i Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1.

- a. të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tëresi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërtlejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të tregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërtlejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- a. u kthen ortakëve kontributet;
- b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c. u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d. lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. jep kredi.

Neni 13 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

Neni 14 Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetëm, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. Mbledhja e Ortakut të Vetëm vendos rrëth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16 Dispozita përfundimtare


Ky Akt themelimi i shoqërisë "Varan Transport " shpk" shpk, u hartua në gjuhën shqipe në 5 (pesë) kopje me vlera të njëjtë juridike dhe nënskruhet me vullnetin e lirë e të plotë të "Ortakut themelues".

ORTAKET E SHOQËRISË


Fatih Küçük


Fatih Küçük

Mustafa Emin Ceyhan


Mustafa Emin Ceyhan

Muhammed Ceyhan


Muhammed Ceyhan

Rahthyer nga: Ingert Petnti



Ceyhan